



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Komisioneri

Nr. 23/1 Prot.

Tiranë, më 21/6 /2011

Lënda: Rekomandim për kontrolluesin Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë

REKOMANDIM

Mbështetur në Ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, Vendimet e Kuvendit të Shqipërisë nr. 211, datë 11.09.2008 “Për zgjedhjen e komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe nr 225, datë 13.11.2008 “Për miratimin e strukturës organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të Zyrës së Komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale”, pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Inspektimit në ngarkim të kontrolluesit, **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë,**

KONSTATOVA

Pranë kontrolluesit, **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë** një grup inspektimi i Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale mbështetur në urdhrin nr. 23 datë 26.04.2011 të Komisionerit ka zhvilluar inspektimin administrativ me objekt:

- Verifikimin e ankesës të z. P. N mbi publikimin e të dhënave personale (vendimi nr. 991 datë 15.02.2011) në faqen zyrtare të internetit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale pasi shqyrtoi, procesverbalin e konstatimit të inspektimit administrativ si dhe provat e administruara gjatë ushtrimit të inspektimit administrativ vëren se:

Kontrolluesi Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ka bërë publikimin në faqen zyrtare të saj në internet, vendimin gjyqësor civil nr. 991 datë 15.02.2011 i cili i përket ankuesit P. N. Publikimi i këtij vendimi është bërë prej këtij kontrolluesi duke u hedhur në sistem në faqen zyrtare të tij në internet, ashtu si kundër ai është në dosjen fizike të çështjes gjyqësore. Qëllimi i publikimit të këtij vendimi është transparenca dhe informimi publik.

Me publikimin e vendimit gjyqësor civil nr. 991 datë 15.02.2011 kontrolluesi, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ka bërë njëkohësisht publike të dhënat personale të ankuesit P. N si, emri, mbiemri, atësia, mëmësia, vendlindja, adresa, kombësia, shtetësia, numri i kartës së identitetit etj, të dhëna personale këto që mbarten në vendimin gjyqësor civil nr. 991 datë 15.02.2011, ku ankuesi si subjekt i të dhënave, ka qenë palë në atë gjykim.

Vendimi gjyqësor në arsyetimin e tij mbart dhe të dhëna të tjera kofidenciale të ankuesit si numrin dhe datën e vendimit të Komisionit të Kualifikimit Shkencor në të cilin ankuesit i është refuzuar dhënia e titullit “profesor” etj. Nxjerrja dhe publikimi i këtyre të dhënave personale, nga ana e kontrolluesit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në faqen zyrtare të saj në internet, e bën subjektin e këtyre të dhënave ankuesin P. N lehtësisht të identifikueshëm për opinionin publik. Vetë objekti specifik i gjykimit, pozita shoqërore e ankuesit P. N kanë çuar në uljen e imazhit dhe të reputacionit të ankuesit P. N duke i sjellë kështu një dëm në jetën e tij, vetëm si rezultat i bërjes publike të të dhënave të tij personale.

Pavarësisht pretendimit të kontrolluesit Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë se, qëllimi i publikimit të vendimit është transparenca dhe informimi publik dhe se kjo është bërë në mbështetje të Kodit të Procedurës Civile në Republikën e Shqipërisë, Komisioneri çmon se, kontrolluesi Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka shkelur privatësinë e subjektit të të dhënave P. N, duke bërë publike të dhënat personale të tij, duke mos respektuar dhe garantuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe në veçanti të drejtën e ruajtjes së jetës private.

Sa më sipër, kontrolluesi Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë në procesin e publikimit të vendimit duhet të bëjë publike vetëm të dhënat që lidhen me identifikimin e trupit gjykues ndërsa për të dhënat personale që lidhen me subjektin e të dhënave i cili është palë në proces gjyqësor, publikimi i tyre duhet të bëhet në atë mënyrë që çdo informacion apo e dhënë personale për subjektin e të dhënave të realizohet në atë mënyrë që subjekti i të dhënave personale të mos bëhet i identifikueshëm si në pjesën arsyetuese të vendimit ashtu dhe në dispozitivin e tij.

Gjithashtu, kontrolluesi Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë **duhet të respektojë nenin 27/6 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” sipas së cilës ai detyrohet të kërkojë mendimin e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale lidhur me procedurat e administrimit të regjistrimit të të dhënave, të hedhjes së të dhënave, të përpunimit dhe nxjerrjes së tyre.**

Nisur sa më sipër në zbatim të neneve 27/6 29, 30 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, si dhe 107-109 të K. Pr. Administrative ;

REKOMANDOJ

Kontrolluesi Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, të marrë masa të menjëhershme teknike dhe organizative, për të bërë të pa identifikueshëm subjektin e të dhënave personale P. N, në vendimin gjyqësor civil nr. 991 datë 15.02.2011, të publikuar në faqen zyrtare në internet.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin,

KOMISIONERI
FLORA ÇABEJ (POGAÇE)